



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5779/Prot.
7

Pogradec, më 30 . 12 . 2022

VENDIM
NR. 145, DATË 28 . 12 . 2022
PËR

“MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE PËR SUBJEKTIN “AL-MAK SHPK ” PËR SHKAK TË RËNIES SË ZJARRIT NË AMBJENTIN KU SUBJEKTI ZHVILLON AKTIVITETIN”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës I të nenit 29, të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 të ligjit nr. 8756, date 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar, VKM nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", ligjin nr.9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, kërkesës nga subjekti si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të Drejtorisë së Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:**

1. Të përjashtohet nga detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për një periudhë tri vjetecare, subjekti "AL-MAK" shpk, me Nipt: K43924703D, me administrator znj. Lira Shehaj.
2. Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere pas shpalljes publike.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

